

6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I RREGULLORES, ÇËSHTJEVE JURIDIKE

PROJEKT-VENDIM

NR. ____ DATË ____/____/2025

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT NR. 30, DATË 26.03.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1032 RRUGA "ALEKS KOMNENI" DHE PALLATIN "KASTRATI" RRUGA "RAMADAN VELIU" TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019" TË NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET MIRATIMIT TË SIPËRFAQEVE SHITESË.

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga procesi i rindërtimit për pallatin nr.1032, rruga "Aleks Komneni" dhe pallatin "Kastrati", rruga "Ramadan Veliu", të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të

datës 26 nëntor 2019”, përsa i përket miratimit të sipërfaqeve shtesë nga diferenca në m² të përfituara nga subjektet përfituese me vendimet përkatëse, sipas Listës së subjekteve përfitues me përbërjen familjare, strukturën e apartamentit si dhe m², hartuar nga Komisioni i Posaçëm dhe kjo listë përbën pjesë integrale të këtij projekt-vendimi.

2. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 “Për miratimin e ndryshimit të vendimit nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.1032, rruga “Aleks Komneni” dhe pallatin “Kastrati”, rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, të ndryshuar”, duke përfshirë në listën bashkëngjitur subjektet përfituese, strukturën e apartamentit si dhe m².
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar .

KOMISIONI I RREGULLORES, ÇËSHTJEVE JURIDIKE

	Pozicioni	Emër Mbiemër	Firma
1	Kryetar	Joniada Musaraj	
2	Zv/Kryetar	Arlind Boshku	
3	Sekretar	Dritan Rakipi	
4	Anëtar	Jurgen Zaza	
5	Anëtar	Edlira Devolli	